

## *Abstrakt*

Në këtë punim është paraqitur pozita kushtetues e Presidenentit të shtetit të Kosovës dhe pozita kushtetuese e presidentit të disa shteteve të tjera si Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të zi dhe SHBA-së, gjithmonë duke u bazuar në kushtetutën dhe ligjet në fuqi të këtyre Shteteve.

Si trajtim kryesorë në këtë punim është marrë krahasimi i pozitës kushtetuese të presidentit të Republikës së Kosovës dhe të këtyre shteteve si ne kriteret e emërimit, procedurës së zgjedhjes, kompetencave, betimit, shkeljeve Kushtetuese, dorëheqjes dhe shkarkimit.

Punimi është strukturuar në pesë kapituj, ku në secilin kapitull është trajtuar pozita kushtetuese e presidentit të një shteti.

Në kapitullin e parë është shtjelluar pozita e Presidentit të Kosovës – ku përfshihet e gjithë fushëveprimtaria e presidentit lidhur me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara nga kushtetuta e Kosovës, ku flitet për secilën veç e veç me qëllim të pasqyrim sa më të mirë të pozitës kushtetuese të presidentit.

Kapitulli i dytë i tretë i katërt dhe i pestë flet për pozitën e presidentit të shteteve si Shqipërisë, Maqedonisë, Malit të zi dhe SHBA-së ku paraqitet pozita e tyre kushtetuese me qëllim të pasqyrimin sa më të mirë të karakteristikave të përbashkëta dhe të veçanta që kanë këto vende me pozitën kushtetuese të Kosovës sa i përket fushëveprimtarisë së presidentit duke parë përcaktimin e kriterëve për kandidim për president, procedurën e zgjedhjes, kompetencat, betimin, shkeljet kushtetuese, dorëheqjen, përfundimin e mandatit si dhe shkarkimin.

**FJALË KYÇE: PRESIDENTI, POZITA KUSHTETUESE, KUSHTETUTA, SHTETI, KOMPETENCAT, ZGJEDHJA, SHKARKIMI.**